



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/ L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 31.3.2026, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE KLUBIT TË BASKETBOLLIT
“SIGAL PRISHTINA”

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare KB “Sigal Prishtina”, për projektin “Bashkëpunimi ndërkombëtar në basketboll”, për periudhën 1.9.2025-30.11.2026.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kodi buxhetor i Drejtorisë së Sportit 85086.

III.

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, rikthimi i klubit në Ligën Evropiane të Basketbollit të Veiut (ENBL), promovimin e Prishtinës në arenën ndërkombëtare, ngritjen e turizmit sportiv dhe forcimin e Akademisë së Basketbollit për Zhvillimin e Talenteve të Reja.

IV.

Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, nga KB “Sigal Prishtina” dhe rekomandimi i komisionit.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditën pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/04-47909/26, më 02.4.2026

KRYESUES I KUVENDIT

Fehmi Kupina

